

“FRASHËRI I SHQUAR, I PANJOHUR” VEPËR ME KARAKTER ENCIKLOPEDIK¹

Në këtë vepër, Thomas Frashëri na sjell për herë të parë fakte që nuk janë vetëm histori familjare. Vepra ka një karakter mirëfilli enciklopedik, kjo sepse autori vjen nga Shkolla e Vjetarëve në Francë dhe për kryerjen e këtij studimi, ai i ka shtuar analizës historiografike metoda ndërdisiplinore, duke shfaqur kështu ndikimin e parimeve të shkollës historiografike franceze.

Në libër është paraqitur historia e një prej familjeve më të shquara të historisë së Shqipërisë, që, njëkohësisht, njihet edhe në Perandorinë Osmane. Frashëri njihet si mbiemri i përbashkët i vëllezërve Frashëri.

Frashëri ishte një nga fshatrat e Toskërisë. Statusi i tij i veçantë që e përjashtonte nga dy sisteme taksash, e mbrojti nga trysnia fiskale përgjatë dy shekujsh (1500-1700), duke i përcaktuar kështu fizionominë e tij sociale. Frashërlinjtë kanë një shfaqje relativisht shumë të hershme në histori, janë zhvilluar gjatë shekujve dhe degëzimet e tyre paraqesin veçori shumë të spikatura, duke filluar nga struktura e organizimit të tyre, aspektet ndërfetare, veprimtaritë etj.

Vëllezërit Frashëri, Abdyli, Naimi dhe Samiu, përbëjnë trinomin e veçantë të historisë, kulturës dhe letërsisë shqipe. Ata, me veprën e tyre, i dhanë frymëzim e forcë lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, në fundin e shekullit të XIX. Pësha historike vendimtare e kësaj vëllazërie është ndjerë thellë dhe gjatë, në të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare. Por, natyrshëm, lindin pyetjet: Si arritën Frashërlinjtë të quhen vëllazëri? Cili është konteksti historik i zonës ku u lindën dhe u rritën? Cilat janë degëzimet e hershme të tyre? Në historiografinë shqiptare kemi mësuar për shumë familje të mëdha shqiptare, si Topiajt, Toptanët, Muzakajt, etj. Përse duhet të mësojmë në veçanti edhe për Frashërlinjtë, përtej veprimtarisë së tyre ideopolitike-kulturore?

Libri “Frashëri i shquar, i panjohur”, është i ndarë në katër pjesë dhe ka dy shtojca. Vepra nis me një parathënie të autorit dhe vazhdon me një

1 Thomas Frashëri, Frashëri i shquar, i panjohur, Tiranë: Onufri, 2022, 870 faqe.

përmbledhje në gjuhën angleze, frënge dhe italiane. Pjesa e parë titullohet: “Përtej kryqit dhe gjysmëhënës”, hulumtime mbi origjinat e një klani. Kjo pjesë nis me një hyrje, përmban një hulumtim të detajuar mbi origjinën e vendbanimit (midis shekujve XIV dhe XVI), duke parashtruar tipare dhe fakte të panjohura. Gjithashtu, bëhet edhe një parashtrim i detajuar mbi emrin “Frashëri”. Është me interes të vërehet se, deri më sot, emri “Frashëri”, në kuptimin e parë të tij, rezulton të jetë emër fisnor dhe shfaqet me forma të ndryshme fonetike, kohë përpara se të hasej në dokumente si emër vendbanimi. Kjo pjesë nis që me periudhën e hershme osmane dhe vazhdon me tradita gojore, dokumente, dëshmi të shfaqjes historike të familjes Frashëri, si edhe ndikimin e krijimit të institucioneve osmane midis shekujve XVI-XIX.

Pjesa e dytë, “Ana pak e njohur e medaljes, Frashëri i kabanave dhe i ikonave”, ashtu si pjesa e parë, nis me një hyrje. Hulumtimet mbi origjinat e Frashërlinjve dhe historinë e tyre të largët shfaqën nevojën e nxjerrjes në pah të degëzimeve të hershme. Kjo pjesë e botimit përmban zbulime që janë pothuajse tërësisht të panjohura më parë. Gjithashtu, në këtë pjesë i kushtohet një vëmendje e veçantë Frashërlinjve të krishterë, që e kalonin jetën mes Shqipërisë dhe Stambollit. Vullneti për të mbetur shqiptarë u kushtonte atyre një izolim jo të vogël në një lagje ortodokse si Bejollli (Pera), ku trysnia greke ishte e fortë. Po kështu, i është dhënë rëndësi heraldikëve dhe simboleve të Frashërlinjve.

Pjesa e tretë, “Bonum nomen, alter patrimonium; të njësuar në emër, të ndarë në fate”, i kushton një vëmendje të veçantë konsolidimit të bashkësisë Frashëri, veçorive të zonës malësore, fafëfisnore, karakteristikave vëllazërore dhe besimit fetar. Rrëfenjat e Sami dhe Mid’hat Frashërit dëshmojnë se, ndonëse tradita e bashkëfarefnisës kishte mbetur në kujtesë, distancimi i degëzimeve e kishte bërë pothuajse të palexueshëm thelbin e historisë, gati si një totem për degëzimet e largëta. Rrjeti i Frashërlinjve dhe ndërvarësitë e vjetra nuk u shpërbënë as pas shpalljes së Pavarësisë, ndoshta edhe vetë Frashërlinjët ishin të vetëdijshëm, se i përkisnin një elite.

Pjesa e katërt, “Fate dhe rrugëtime pak të njohura”, ofron një përmbledhje me 17 biografi të personaliteteve që vijnë nga linjat historike të Frashërit. Shumë prej tyre na prezantohen për herë të parë. Kjo pjesë nis me Anastas Frashërin, Andon S. Frashërin, Athina Frashëri-Turtullin dhe vazhdon me një përpjekje për të shpëtuar nga harresa jetën dhe veprat e më të voglit prej vëllazërve Frashëri, Mehmet (Emin) bej Frashërit, i cili zotëronte kulturë të lartë për kohën dhe rrethin e tij, ku fare i ri u përfshi në lëvizjen kombëtare. Ai ishte anëtar i Shoqërisë së Stambollit dhe në

vjeshtën e vitit 1908, filloi të botonte gazetën “Besa”, e cila, ndonëse u shtyp për pak kohë, i dha hov Mid’hat Frashërit dhe Shahin Kolonjës për të vazhduar veprimtarinë në këtë drejtim.

Gjurmimi dhe hulumtimi i familjeve historike Frashëri ka ndihmuar në rindërtimin e një kronologjie. Shpalosja deri në fund e të pathënave mbi Frashërlinjtë, sidomos të atyre të mbetur disi në hije, krijojnë një panoramë dhe një lidhje logjike me faktet historike. Shtojca e parë që vijon, na sjell disa të dhëna plotësuese për disa paraardhës të dalluar të familjes Frashëri, ndërsa shtojca e dytë na ofron një repertor fotografish dhe ilustrimesh në lidhje me Frashërlinjtë.

Kjo vepër është më shumë se një libër studimor. Në të paraqiten ilustrime, harta, shënime, fotografi të rralla, dorëshkrime, stema familjare, letra etj., që na rindërtojnë para syve një fotografi të gjallë të së kaluarës, duke na futur brenda një mozaiku të klanit të Frashërlinjve.